



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 286/1 Prot.

Tiranë, më 11.02.2025

**V E N D I M**

**Nr. 33, Datë 11.02.2025**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 109, datë 22.05.2024<sup>1</sup>, e paraqitur nga: z. S.F, z. Xh.M, z. Gj.Ll dhe z. O.V kundër Shoqërisë së Transportit “KESIDA” sh.p.k<sup>2</sup>, me pretendimin për diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar<sup>3</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Me datë 08.05.2024 Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit” kishte organizuar një mbledhje me të verbërit e Bashkisë së Cërrikut. Në këtë mbledhje morën pjesë, Presidenti i Shoqatës, S.F, zv. Presidenti, Xh.M, zv. Kryetari i Degës së Tiranës, Gj.Ll dhe anëtarë i bordit, O.V, që të gjithë me statusin e të verbërit. Kemi hipur në autobus rreth orës 16:10 në qytetin e Cërrikut, për tu kthyer në Tiranë, në autobusin me targa AAxxxOC dhe kemi arritur në Tiranë në orën 17.00.

<sup>1</sup> Ankesa është plotësuar me identifikimin e subjektit kundër të cilit është bërë ankesa, me shkresën e dërguar nga DPSHTRR, nr. 10136/1, datë 28.05.2024.

<sup>2</sup> NUIS K41xxxx21N.

<sup>3</sup> Referuar Librezave të Verbërisë: nr. 06251, të z. S.F, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror; nr. 05136, të z. Xh.M, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror; nr. 07574, të z. Gj.Ll, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror; nr. 04934, të z. O.V, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

*Autobusi nuk kishte faturino dhe pagesa e biletës bëhej te shoferi, i paraqitëm shoferit librezat e verbërisë dhe i thamë që të verbërit duhet të udhëtojnë me gjysëm bilete, ai tha që në linjën tonë nuk njihen librezat, unë jam punëtor dhe duhet ti çoj lekët pronarit.*

*I kërkua të na pajisi me biletë dhe na dha katër bileta<sup>4</sup>, por të katërta biletat nuk kanë të njëjtat tarifa me njëra tjetrën dhe as nuk korrespondojnë me targën e autobusit. Pagesat e biletave u bënë të plota sipas çmimit të biletave”.*

Subjektet ankues, kërkojnë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të tyre për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Shoqërisë së Transportit “Kesida” sh.p.k dhe eliminimin e pasojave të ardhura si rezultat i diskriminimit.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Bazuar në nenin 7 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:

<sup>4</sup> Referuar biletave me numër serie: 005647; 005648; 005649 dhe 005650, seria N/10.

- a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;
- b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: .....

c) kontributin dhe mundësinë për të përfiturar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun...”

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në kushtet kur, pala ankuese nuk kishte mundur që të identifikonte subjektin i cili ofron shërbimin e transportit ndërqytetës në linjën Tiranë-Gramsh, me të cilën kishin udhëtuar në datën 08.05.2024, datë në të cilën pretendohet se është konsumuar sjellja diskriminuese; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës nr. 789/2, datë 24.05.2024, i është drejtuar për marrjen e informacionit dhe identifikimin e subjektit i cili ofron këtë shërbim, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Me shkresën nr. 10136/1, datë 28.05.2024<sup>5</sup>, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përcolli informacionin duke sqaruar ndër të tjera se: “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në zbatim të Urdhërit nr. 318, datë 02.11.2020 “Për delegim kompetence”, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, është organi kompetent për nënshkrimin e licencave dhe certifikatave në transportin ndërqytetas të udhëtarëve me autobus dhe nuk ka kompetenca kontrolli në terren për shpërndarjen e biletave në transportin ndërqytetës.

Linja e rregullt e transportit të udhëtarëve Tiranë-Gramsh-Tiranë është e miratuar me Udhëzimin nr. 5628, date 18.11.2016 “Për miratimin e rregullit të linjave ndërqytetëse”, i ndryshuar, dhe lëshimi i licencës/certifikatave për operimin në këtë linjë kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Nga verifikimi në sistemin elektronik e-Transport, rezulton se në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës Tiranë-Gramsh-Tiranë, është licencuar shoqëria “Kesida” shpk, me NIPT

<sup>5</sup> Protokolluar pranë KMD-së me nr. 695/2 prot., datë 29.05.2024.

*K4xxxx21N, mbajtës i licencës me nr. 84, lëshuar në datë 21.06.2022, me afat vlefshmërie deri në datë 20.06.2027.*

*Për sa i përket kërkesës për informacion për mjetin me targë AAxxxOC, rezulton në pronësi të subjektit “Kesida” shpk dhe është i pajisur me certifikatë operimi nr. 2, lëshuar në datë 19.06.2023, me afat vlefshmërie deri në datë 19.06.2024, në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës të udhëtarëve Tiranë-Gramsh-Tiranë”.*

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

- Me shkresën nr. 789/3, datë 03.06.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjekti, lidhur me pretendimet e ankuesve, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
  - Informacion nga ana e Shoqërisë “Kesida” sh.p.k, lidhur me situatën e pretenduar nga ana e ankuesve.
  - Informacion nëse nga ana e Shoqërisë “Kesida” sh.p.k, ofrohet transporti i personave me aftësi të kufizuara, në veçanti personave të verbër, bazuar në lehtësirat financiare të parashikuara në Udhëzimin e Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”.
  - Kopje të licencës të Shoqërisë “Kesida” sh.p.k.
  - Kopje të certifikatës për kryerjen e shërbimeve të rregullta ndërqytetëse të mjetit me targa: AAxxxOC.

Me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 789/4, datë 20.06.2024, Shoqëria Kesida shpk, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “... Për pretendimin se janë diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar shprehemi se personat nuk janë diskriminuar, por janë konsideruar të barabartë si udhëtarët e tjerë... Pra subjekteve në fjalë nuk i është mohuar barazia.

*Kurse për sa i takon respektimit të Ligjit nr. 26/2012, datë 15.03.2012 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”, neni 11, i cili parashikon se: “Të verbrit dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masat, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.*

*Në nenin 85 të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar), parashikohet: “Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt*

*të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit... Fondet për kompensimin e tarifës së transportit të kategorive të personave, që përfitojnë nga legjislacioni në fuqi për transportin qytetas, përballohet nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit. Masat, kriteret dhe procedurat për kompensimin e kësaj tarife përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.*

*Shprehemi se deri më sot nuk është përcaktuar asnjë masë, mënyrë dhe formë kompensimi, për shoqëritë që kryejnë veprimtarinë e transportit rrugor ndërqytetës, duke krijuar një mangësi ligjore, jo në pak raste edhe përplasje si ky rast në këtë shpjegim.*

*Për rastin konkret të paraqitur nga ankuesit, shprehemi se drejtuesi i autobusit me targë AAxxxOC nuk ishte i njohur mbi ekzistencën e parashikimeve të nenit 11 të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, të ndryshuar, ku shprehimisht parashikohet se: “Të verbërit kanë të drejtë që ata vetë dhe shoqëruesit e tyre të udhëtojnë ..... me gjysmë çmimi në transportin interurban”.*

*Drejtuesit të mjetit ju bë e ditur që në të gjitha rastet në vijim për të gjithë individët që paraqesin librezën e të verbërit, të respektojë parashikimet e nenin 11 të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, të ndryshuar, duke paguar 50% të çmimit të biletës.*

*Për sa më sipër shoqëria “Kesida” Shpk, pavarësisht mangësive ligjore dhe duke mbartur mbi vete një kosto financiare të cilën ligjërisht duhet ta mbajë shteti, do të vazhdojë të ofrojë ndihmesën me të gjitha mundësitë e saj për lehtësirat financiare, për të mundësuar transportin e personave me aftësi të kufizuar dhe në veçanti të individëve që kanë statusin e të verbërit.*

*Njëkohësisht duke i kërkuar ndjesë Shoqatës “Shpresë për të Verbërit”, për rastin e analizuar më sipër, Ju falënderojmë për bashkëpunimin”.*

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesit të cilët janë drejtues të Shoqatës “Shpresë për të Verbërit”, nëpërmjet shkresës nr. 789/5, datë 20.06.2024, janë njohur me përgjigjen e Shoqërisë “KESIDA” shpk. Ankuesit nuk depozituan prapësime me shkrim.

- Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar” dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, me shkresën nr. 789/6, datë 03.09.2024, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 09.09.2024.

Seanca dëgjimore e planifikuar për tu zhvilluar në datë 09.09.2024, nuk u zhvillua për arsye se Shoqëria “Kesida”, pas komunikimit me telefon informoi se nuk kishte marrë njoftimin në kohë nga shërbimi postar. Në këto kushte u vendos për shtyrjen e zhvillimit të seancës dëgjimore.

- Me shkresën nr. 789/8, datë 02.10.2024, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 14.10.2024.

Seanca u zhvillua në datë 14.10.2024, me praninë e palëve pjesë e procedurës administrative. U paraqitën personalisht ankuesit, S.F dhe Xh.M, nuk u paraqitën ankuesit Gj.Ll dhe O.V. Për Shoqërinë “Kesida”, u paraqit z. H.H, sipas autorizimit të lëshuar nga administratori i shoqërisë.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Gjatë seancës dëgjimore, z. S.F në mes të tjerash deklaroi se: *“I kam paraqitur shoferit librezën e verbërisë dhe i kam thënë se duhet të paguaj gjysmën e vlerës së biletës dhe shoferi tha se nuk e njoh librezën dhe duhet të paguani vlerën e plotë. Rasti me Shoqërinë Kesida është i përsëritur për personat e verbër”*.

Gjatë seancës dëgjimore, z. Xh.M në mes të tjerash deklaroi se është i pajisur me tre librezat si person me aftësi të kufizuara, si invalid i punës, librezën e shoqatës dhe librezën e SHSSH dhe se ditën e udhëtimit i ka paraqitur të tre librezat.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Shoqërisë Kesida, në mes të tjerash deklaroi se: *“Shoferi është drejtues mjete dhe nuk e ka njohuri se cila librezë është e vlefshme dhe që duhet marrë në konsideratë. Situata ka ndodhur, por shoferi ka qenë i painformuar dhe nuk ka njohuri të ligjit”*.

- Me shkresën nr. 789/9, datë 15.10.2024, Komisioneri ka kërkuar informacion nga z. Gj.Ll dhe z. O.V duke i pyetur se cilën librezë i kanë treguar shoferit gjatë udhëtimit. Ankuesit nuk kthyen përgjigje.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.**

*Bazuar në parashtrimet, kronologjinë e ngjarjeve dhe dokumentacionin e depozituar nga palët në këtë proces, Komisioneri vëren se:*

Ankuesit, S.F, i datëlindjes 03.05.1966, Gj.Ll, i datëlindjes 18.03.1952, O.V, i datëlindjes 22.03.1955 dhe Xh.M, i datëlindjes 05.05.1957, janë të gjithë persona me aftësi të kufizuara në shikim, fakt që rezulton i provuar nga Librezat e Verbërisë respektivisht nr. 25980, nr. 07574, nr. 25068 dhe nr. 24317, lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, duke qenë në këtë mënyrë përfitues të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 *“Për Statusin e të Verbërit”*, i ndryshuar.

Ankuesit deklarojnë se, kanë udhëtuar në datën 08.05.2024 nga Cërriku për në Tiranë. Ata kanë hipur në autobusin e linjës Gramsh-Tiranë në qytetin e Cërrikut, rreth orës 16:10 dhe kanë arritur në Tiranë rreth orës 17.00. Kur kanë arritur në Tiranë i kanë paraqitur shoferit librezat e verbërisë dhe i kanë *thënë që duhet të paguajnë gjysëm bilete*, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8098, neni 11. Shoferi i ka thënë *që në linjën tonë nuk njihen librezat, unë jam punëtor dhe duhet ti çoj lekët pronarit*. Ankuesit deklarojnë se, pavarësisht insistimit të tyre për të paguar gjysmën e çmimit të biletës, përfundimisht u detyruan të paguanin çmimin e plotë të biletës. Ankuesit deklarojnë se kanë arritur të identifikojnë targën e autobusit AAxxxOC.

Rezultoi e provuar gjatë shqyrtimit të ankesës se, linja e transportit në të cilën kanë udhëtuar ankuesit është një linjë e transportit ndërqytetës që lidh qytetin e Gramshit me Tiranën. Në bazë të informacionit të administruar rezultoi se, autobuzi me targa AAxxxOC, me të cilin ankuesit kanë udhëtuar, është i pajisur me certifikatë operimi nr. 02, lëshuar në datë 19.06.2023, me afat vlefshmërie deri në datë 19.06.2024 në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës të udhëtarëve Tiranë-Gramsh-Tiranë, mjet i certifikuar për operim në emër të Shoqërisë Kesida sh.p.k, me NIPT K41619021N.

Shoqëria Kesida sh.p.k, ofron shërbimin e transportit në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës Tiranë-Gramsh-Tiranë bazuar në licensën me nr. 84, lëshuar në datë 21.06.2022, nga DPSHTRR, me afat vlefshmërie deri në datë 20.06.2027.

Në ankesën e depozituar nga ana e ankuesve, pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, të verbër, nga ana Shoqërisë së Transportit Kesida sh.p.k, përmes mosnjohjes të së drejtës për të udhëtuar me 50% të çmimit të biletës në linjën e transportit ndërqytetës Tiranë-Gramsh-Tiranë, ndërkohë që një gjë e tillë është e parashikuar në legjislacionin përkatës.

Lidhur me këtë moment, Komisioneri ka analizuar dispozitat ligjore që normojnë të drejtën e udhëtimit në transportin urban ndërqytetas të kategorisë së personave me aftësi të kufizuar/të verbër, me biletë me gjysëm çmimi.

Mbështetur në legjislacionin në fuqi<sup>6</sup> që rregullon fushën e transportit, transporti rrugor i udhëtarëve brenda vendit në formën e shërbimit të linjave të rregullta, ndahet në: (1) transport qytetas, (2) transport rrethqytetas<sup>7</sup> dhe (3) transport ndërqytetas. Transporti ndërqytetas rregullohet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë e transportit, i cili nëpërmjet Urdhrit nr. 318, datë 02.11.2020, “*Për delegim kompetence*”, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, ka autorizuar Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), si organin kompetent për lëshimin e licencave dhe certifikatave në transportin ndërqytetës, mbi bazën e rrejtit të linjave të miratuar me udhëzim të Ministrit përgjegjës për transportin rrugor. Në rastin objekt shqyrtimi, jemi përpara rastit të transportit ndërqytetas.

<sup>6</sup> Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

<sup>7</sup> Transporti rrethqytetas nuk bën pjesë në objektin e shqyrtimit të kësaj ankese.

Me qëllim identifikimin e bazës ligjore që përmban parashikime pozitive, lidhur me përfitimin e transportit falas dhe 50% për kategorinë e personave të verbër, Komisioneri, mori në analizë Ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit” (Ndryshuar me ligjin nr. 26, datë 15.03.2012). Referuar dispozitave të ligjit të sipërpërmendur, rezultoi se, fillimisht neni 11, i këtij ligji parashikonte shprehimisht: “Të verbërit kanë të drejtë që ata vetë dhe shoqëruesit e tyre të udhëtojnë falas në transportin urban, dhe me gjysmë çmimi në transportin interurban, duke përfshirë atë shtetëror dhe privat”.

Në vijim, neni 11, i ligjit të sipërpërmendur është ndryshuar, nëpërmjet ligjit nr. 26, datë 15.03.2012 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit””. Aktualisht, ky nen parashikon: “Të verbërit dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Sikurse vihet re nga sa më sipër, pas ndryshimeve, që i janë bërë në vitin 2012, Ligjit 8098/1996 “Për Statusin e të Verbërit” (i ndryshuar), personat e verbër nuk përfitojnë më transport qytetas/urban<sup>8</sup> falas dhe transport interurban<sup>9</sup>/ndërqytetas me 50% të vlerës së biletës. Me ndryshimet ligjore, kjo kategori do të përfitojë kompesim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është miratuar ende.

Në vendimmarrjet e mëparshme të KMD-së<sup>10</sup> lidhur me mungesën e daljes së këtij akti rregullator nënligjor/VKM, Komisioneri, ka rekomanduar që:

- Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 85, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar.
- Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar.
- Këshilli i Ministrave të marrë masa për ndryshimet në legjislacion dhe në aktet nënligjore, sipas nenit 20, të Ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”.

VKM nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar, në pikën 3 dhe 10, të tij ka parashikuar se: “3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror i lëshon personit të verbër librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr.8098, date 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë. Modeli i librezës së verbërisë përcaktohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.....10. Udhëtimi në transportin e brendshëm shtetëror

<sup>8</sup> Terminologji e përdorur në këto ligje;

<sup>9</sup> Terminologji e përdorur në këto ligje;

<sup>10</sup> Vendimi nr. 67, datë 10.06.2019; Vendimi nr. 146, datë 06.08.2021; Vendimi nr. 174, datë 20.09.2021, i KMD-së, etj.

dhe privat për personat e verbër bëhet me 0% të tarifave për transportin urban dhe 50% të tarifave për transportin interurban. Këtë tarifë e përfiton edhe shoqëruesi i të verbërit të grupit të parë”.

Legjislacioni i miratuar në fushën e transportit përmban parashikime të përgjithshme mbi lehtësitë, që duhet të përfitojnë në shërbimin e transportit urban ndërqytetas, për shtresat dhe kategoritë vulnerabël, por gjithmonë duke kryer referencën përkatëse, në ligjet e posaçme për secilën kategori. Lidhur me lehtësirat dhe të drejtën e personave me statusin e të verbërit, për të udhëtuar në transportin ndërqytetas, neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar)<sup>11</sup> parashikon: “Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjies për ta. Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta”. Bazuar në sa më sipër, ligji ua njeh këtë të drejtë të gjithë personave me statusin e të verbërit, konform detyrimit për të paraqitur në çdo rast udhëtimi dokumentin ligjor specifik.

Udhëzimi nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, “Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”, bën një identifikim të grupeve, që përfitojnë lehtësira financiare në marrjen e shërbimeve publike në përputhje me kuadrin ligjor, por jo llojin e lehtësirave që përfitojnë. Sipas këtij udhëzimi, personat që u përkasin kategorive apo grupeve në fjalë, pajisen me *Kartat standarde të personalizuar*. Në pikën 5.3.2.1, 5.3.2.2 dhe 5.3.2.4, të udhëzimit, përcaktohen si të tillë: invalidët e punës, të verbërit dhe invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Në pikën 5.3.2.6, të Udhëzimit nr. 3743/2017, parashikohet si përfitues edhe çdo subjekt ose kategori që mund të përfitojë në vijim, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, rezulton se personat me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin e të verbërit gëzojnë lehtësira në shërbimin e transportit, duke përfshirë këtu të treja format e transportit me linja të rregullta, pra transport qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas.

Udhëzimi nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, i ndryshuar<sup>12</sup>, në nenin 14, përcakton: “5. Subjekti është i detyruar të zbatojë legjislacionin në fuqi për personat me aftësi të kufizuara dhe t’i krijojë sa më shumë lehtësira për transport kësaj kategorie udhëtarësh. Mos zbatimi i legjislacionit në fuqi për transportin e personave me aftësi të kufizuara përbën shkelje të rëndë, e cila shkon deri në pezullimin ose heqjen e licencës dhe, ose certifikatës së autobusit”. Pjesë përbërëse e këtij udhëzimi janë edhe lidhjet që i bashkëlidhen këtij akti, në të cilat parashikohen dispozita të

<sup>11</sup> Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ndryshuar me ligjet: nr. 8908, datë 6.6.2002, nr. 9096, datë 3.7.2003, nr. 9373, datë 14.4.2005, nr. 9760, datë 21.6.2007, nr. 10137, datë 11.5.2009, nr. 10 302, datë 15.7.2010, nr. 118 /2012, datë 13.12.2012, nr.21/2013, datë 14.2.2013, nr. 37/2014, datë 10.4.2014, nr. 10/2016, datë 11.2.2016.

<sup>12</sup> Ndryshuar me: Udhëzimin nr. 3918, datë 18.07.2017, Udhëzimin nr. 438, datë 9.5.2018, Udhëzimin nr. 6, datë 2.11.2020 dhe Udhëzimin nr. 7, datë 03.02.2022.

përgjithshme ku formulohen detyrimet e mbajtësit të licencës që ofron shërbimet e transportit, përfshi edhe transportin ndërqytetës. Konkretisht në Lidhjen 4, të udhëzimit parashikohet:

*“4. Mbajtësi i licences dhe i kësaj certificate mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve nr. 7889/94, të ndryshuar, nr. 7663/93, nr. 8626/00, të ndryshuar në të cilat përcaktohet: .....*

*b) Për transportin rrethqytetës dhe ndërqytetës: Mbajtësi i licencës mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve 7889/94, të ndryshuar, nr. 7663/93, nr. 8626/00, të ndryshuar, në të cilat përcaktohet:*

*- “invalidët e punës, invalidët e luftës, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët nga organizatat përkatëse janë të pajisur me dëshmi, kanë të drejtë të udhëtojnë me 50 % të vlerës së biletës”, si dhe për zbatimin e ligjeve nr. 8098/96, të ndryshuar, nr. 8153/96:*

*- “të verbrit e shoqëruesit e tyre dhe jetimët që nuk janë në marrëdhënie pune, udhëtojnë falas.*

*5. Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjithë personat që i përfitojnë këto lehtësi në transportin në linjat e rregullta, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e tyre të ndenjes”.*

Referuar Licencës nr. 84, datë 21.06.2022, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, për Shoqërinë “Kesida”, në dispozitat e përgjithshme të kësaj licence, në pikën 8.1, germa d) dhe pikën 8.2, germa e) parashikohet se: *“8.1 Licenca pezullohet nga autoriteti i licencimit që e ka lëshuar atë, kur mbajtësi i saj: d) Nuk zbaton legjislacionin në fuqi, për personat me aftësi të kufizuara, të konstatuara nga organet e kontrollit” dhe pika 8.2 “Autoriteti kompetent i licencimit, do të heqë licencën kur mbajtësi i saj: e) Nuk zbaton legjislacionin në fuqi në mënyrë të përsëritur, të konstatuara nga organet e kontrollit, për personat me aftësi të kufizuara”.*

Gjithashtu, në Certifikatën nr. 2, datë 19.06.2023 të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, për mjetin me targë AA394OC, në dispozitat e përgjithshme të kësaj licence, në pikën 4, germa b) parashikohet se: *“Për transportin rrethqytetës dhe ndërqytetës: Mbajtësi i licencës mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve nr. 7889/94, të ndryshuar, nr. 7663/93; nr. 8626/00, të ndryshuar, në të cilat përcaktohet: “- invalidët e punës, invalidët e luftës, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët nga organizatat përkatëse janë të pajisur me dëshmi, kanë të drejtë të udhëtojnë me 50% të vlerës së biletës, si dhe për zbatimin e ligjeve nr. 8098/96, të ndryshuar, nr. 8153/96. – “të verbrit e shoqëruesit e tyre dhe jetimët që nuk janë në marrëdhënie pune, udhëtojnë falas”.*

Për sa më sipër, Komisioneri vëren se, Shoqëria Kesida shpk, bazuar në kushtet e licencës dhe certifikatës, ka përgjegjësi për sigurimin e lehtësirave për transportin e personave me aftësi të kufizuara në përgjithësi dhe atyre të verbër në veçanti.

Me shkresën datë 18.06.2024, Shoqëria Kesida, është shprehur që në zbatim të udhëzimeve të licencës, ofron shërbimin për personat me aftësi të kufizuara, por drejtuesi i mjetit nuk ka pasur

dijeni për parashikimet ligjore për të verbërit. Gjithashtu, Shoqëria informoi se ju bë e ditur drejtuesit të mjetit se personat e verbër dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë udhëtim me gjysëm çmimi dhe pavarësisht mangësive ligjore duke mbartur mbi vete një kosto financiare, do të vazhdojë të ofrojë ndihmesën me të gjitha mundësitë e saj për lehtësirat financiare, për të mundësuar transportin e personave me aftësi të kufizuar.

Në formularin e ankesë dhe gjatë seancës dëgjimore z. S.F, ka deklaruar se ka paraqitur librezën e verbërisë, por pa saktësuar se cilën librezë. Z. Xh.M gjatë seancës dëgjimore ka deklaruar se ka paraqitur të tre librezat. Z. Ll dhe z. V nuk i kanë kthyer përgjigje Komisioneri, se cilën librezë kanë paraqitur.

Referuar vendimeve të mëparshme të Komisionerit, z. S.F ka deklaruar<sup>13</sup> se në të gjitha udhëtimet e linjave të ndryshme të transportit rrugor, paraqet librezën e lëshuar nga Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, pasi në gjykimin e tij ka të njëjtën fuqi ligjore dhe duhet të përfitojë dhe gëzojë të njëjtat lehtësira ligjore. Në vlerësim të sa më sipër, rezulton se ankuesit janë të paqartë në deklaratimet e tyre lidhur me librezën që kanë paraqitur gjatë udhëtimit.

Sikurse më sipër rezulton, personat me statusin e të verbërit, përfitojnë nga lehtësirat në udhëtim, konform *detyrimit* për të paraqitur në çdo rast udhëtimi *dokumentin ligjor specifik*.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar, autoriteti përgjegjës dhe zyrtar për paisjen e personave të verbër me dëshminë zyrtare të identifikimit, librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar, pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë, është Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror. Pra, Libreza e Verbërisë, e lëshuar nga autoritete të tjera, përfshi këtu Shoqatën “Shpresë për të verbërit”, nuk shërben si dokument provues për të përfituar sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", të ndryshuar.

Nga verifikimi i kryer nga ana e Komisionerit në informacionin e disponuar dhe administruar nga ana e tij në kuadër të shqyrtimit të ankesave për diskriminim, rezulton që ka pasur dhe një ankesë tjetër të së njëjtës natyrë të paraqitur në datë 09.05.2024 kundër Shoqëria Kesida sh.p.k, në të cilën Komisioneri është shprehur me Vendimin nr. 189, datë 08.07.2024<sup>14</sup>, në të cilin ka konstatuar mosdiskriminimin e subjektit ankues, me arsyetimin se ankuesi për të përfituar nga lehtësirat në udhëtim në linjat e transportit ndërqytetas duhet të tregojë dokumentin ligjor përkatës dhe jo Libreza e Verbërisë, të lëshuar nga Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”.

---

<sup>13</sup> Referuar deklarimeve në seancat: datë 22.08.2024, në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 111, datë 22.05.2024, seancës dëgjimore datë 18.12.2024, në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 152, datë 22.07.2024 dhe seancës datë 19.12.2024, në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 168, datë 22.08.2024.

<sup>14</sup> <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2024/07/Vendim-nr.-189-date-08.07.2024-Xh.-D.-kunder-Shoqerise-Kesida-shpk-Mosdiskriminim.pdf>

Referuar shkresës nr. 11103/1, datë 13.06.2024, të DPSHTRR<sup>15</sup>, theksohet se aktualisht, shoqëritë e transportit ndërqytetës nuk përfitojnë subvencion për transportin e udhëtarëve që duhet të udhëtojnë falas. Kjo është një problematikë e parashtruar vazhdimisht nga shoqatat e transportit ndërqytetës në institucionet qendrore përgjegjëse për nxjerrjen e akteve ligjore/nënligjore përkatëse.

Përfundimisht, duke mbajtur në konsideratë:

- Paqartësitë që ekzistojnë në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, në lidhje me mënyrën e përfitimit të lehtësirave në transport nga ana e personave me aftësi të kufizuara, përfshi personat që përfitojnë nga statusi i të verbërit. Pa paragjykuar këtu detyrimet që shoqëria ka marrë përsipër në momentin e pajisjes së saj me licensë;
- Sjelljen e Shoqërisë Kesida dhe angazhimin e saj për të mos lejuar përsëritjen në të ardhmen të situatave të të njëjtës natyrë;
- Parregullsitë në dokumentacionin përkatës provues të paraqitur nga ana e ankuesve;
- Qëllimin parandalues të Komisionerit dhe jo vetëm konstatues dhe ndëshkues.

Komisioneri arrin në përfundimin se, Shoqëria Kesida sh.p.k, nuk duhet të gjendet përgjegjëse për shkelje të dispozitave të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2024 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar në dëm të ankuesve, S.F, Xh.M, Gj.Ll dhe O.V.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasve: S.F, Xh.M, Gj.Ll dhe O.V, për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Shoqërisë “KESIDA” shpk.
2. Rekomandohet Shoqëria “KESIDA” shpk që me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, të marrë masat e mëposhtme:
  - Të afishojë në vende të dukshme në mjetet e transportit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të udhëtuar sipas lehtësirave të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe politikat e shoqërisë për mënyrën e ofrimit të udhëtimit për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar;

---

<sup>15</sup> Kjo shkresë është administruar nga Komisioneri në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 110, datë 22.05.2024, për të cilën Komisioneri ka disponuar me Vendimin nr. 238, datë 09.09.2024.

- Të parashikojë në rregulloren e brendshme të shoqërisë, detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara për këtë kategori;
- 3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë Vendim, Shoqëria “KESIDA” shpk, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
- 4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**